REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

Nr. 103 prot. Kamëz, më 17.12.2025

V E N D I M
Nr. 91 .Datë 17/12 2025
MBI

"MIRATIMIN E NJË NDRYSHIMI NË LISTËN E SUBJEKTEVE TË VENDIMIT NR.11 DT.28.01.2022 TË CILËT PËRFITOJNË NGA PROGRAMI I RINDËRTIMIT PËR OBJEKTET KOLEKTIVE TË ZONËS SË RE PËR ZHVILLIM, VALIAS, TË RINDËRTUARA SI PASOJË E DËMTIMIT NGA FATKEQËSIA NATYRORE E TËRMETIT TË DATËS 26 NËNTOR 2019"

Këshilli Bashkiak Kamëz i mbledhur sot me datë 17.12.2025, pasi mori në shqyrtim Projekt-vendimin Nr.80 Datë 09.12.2025 në mbështetje të ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", Aktit Normativ nr. 09, datë 16.12.2019, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore" dhe akteve nënligjore për zbatim të tij, Vendimit nr. 750, datë 27.11.2019 "Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në qarqet Durrës, Tiranë dhe Lezhë", të ndryshuar; Vendimit Nr. 904, datë 24.12.2019 "Për përcaktimin e rregullave, të kategorive prioritare, masës së përfitimit, autoriteteve përgjegjëse dhe procedurave për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga disa programe të procesit të rindërtimit"; Vendimit nr.5, datë 06.01.2020 i ndryshuar "Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave për përfitimet nga programi i granteve të rindërtimit dhe projektet model"; Vendimit nr.8, datë 06.01.2020 "Për përcaktimin e kushteve dhe të kritereve të përfitimit të sipërfaqeve ndërtimore në objektet e reja për banim nga subjektet që posedojnë ndërtime të klasifikuara si ndërtime pa leje"; Vendimit Nr. 887, datë 24.12.2019 "Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurës së përshpejtuar për hartimin dhe miratimin e planit të detyruar vendor, si dhe procedurës së miratimit të zhvillimit/ndërtimit, në rastet e fatkeqësisë natyrore"; Vendimit Nr. 468, datë 10.6.2020 "Për shpalljen e Zonës së Re për Zhvillim, në fshatin Valias, Bashkia Kamzë, dhe caktimin e Fondit Shqiptar të Zhvillimit si njësi zbatuese"; Vendimit nr.22, datë 13.02.2020, të Këshillit Bashkiak Kamëz "Për miratimin e manualit të proçedurave për përfitimin nga programet e rindërtimit" për shkak të tërmetit të 26.11.2019 , Vendimit nr.130, datë 18.09.2025 dhe nr.4558, datë 06.12.2024 të "Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë" **Këshilli Bashkiak Kamëz";**

V E N D O S I:

1. Miratimin e një ndryshimi në listën e subjekteve përfitues të VKB nr.11 datë 28.01.2022 referuar vendimit nr.130, datë 18.09.2025 dhe nr.4558, datë 06.12.2024 të "Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë" të shfuqizohet znj.K. N nga Programi i Rindërtimit dhe të zëvëndësohet me znj.P. K në cilësinë e ish-banores së objekteve

kolektive të Zonës së Re për Zhvillim, Valias, të rindërtuara si pasojë e dëmtimit nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26 nëntor 2019 .

2. Të dhënat e subjekteve të përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi, së bashku me të dhënat e apartamentit për të cilin bëhet ky ndryshim, paraqiten në aneksin bashkëlidhur dhe pjesë e këtij vendimi.

3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimit të nenit 55, pika 6, të ligjit nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", të ndryshuar.

KRYETAR KËSHILLI
Hysen KOLDASHI